



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Data: 14.1.2025

Nr. 16

VENDIM

PËR

**EMËRIMIN E NDIHMËSIT TË AUDITIT TEKNICIEN, PËR MBIKËQYRJEN E PROCESIT TË HARTIMIT TË LISTAVE TË ZGJEDHËSVE, SI DHE LISTAVE TË ZGJEDHËSVE ME BANIM JASHTË VENDIT, PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” dhe 2, nenit 25, pika 11, dhe nenit 61, pikat 2 dhe 3 të ligjit, nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, udhëzimit nr. 2, datë 28.12.2012, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, “Për miratimin e rregullave të veçanta për kushtet e kontratës dhe kryerjen e auditimit nga auditët teknikienë për verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile”, vendimit nr. 3, datë 8.1.2025, “Për emërimin e auditit teknikien për mbikëqyrjen e procesit të hartimit të listave të zgjedhësve si dhe listave të zgjedhësve me banim jashtë vendit, për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 maj 2025”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S I N:

1. Emërimin e z. Arjan Bici, si ndihmës të auditit teknikien, për mbikëqyrjen e hartimit të listave të zgjedhësve, si dhe listave të zgjedhësve me banim jashtë vendit, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025.
2. Caktimin e masës së shpërblimit në vlerën 236.664 (dyqind e tridhjetë e gjashtëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë, për ndihmësin e auditit teknikien për periudhën, nga momenti i emërimit deri në dorëzimin e raporteve përfundimtare.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Data: 14.1.2025 Nr: 16



“Për emërimin e ndihmësit të auditit teknikien për mbikëqyrjen e procesit të hartimit të listave të zgjedhësve si dhe listave të zgjedhësve me banim jashtë vendit, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Lealba PELINKU**

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: 14.1.2025 Nr: 16



“Për emërimin e ndihmësit të auditit teknikien për mbikëqyrjen e procesit të hartimit të listave të zgjedhësve si dhe listave të zgjedhësve me banim jashtë vendit, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”